

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“EDEL MODEN ” SHPK**

Në Tiranë, sot më datë 25.05.2020, (dymijë e njëzet) shtetasit:

Edmond Hamdi Topi, shtetas gjerman, i datëlindjes 01.07.1960, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me kartë identiteti, me nr L740Z3KTR, dhe numër personal 529145 dhe

Dr. Mirela Esat Oktrova, shtetase gjermane dhe shqiptare, e datëlindjes 03.05.1965, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e identifikuar me kartë identiteti, me nr. 0324550203, me numër personal G55503201C

me cilësinë e ortakëve themelues, redaktuan aktin e themelimit, nëpërmjet të cilit deklarojnë se me vullnet të lirë, të plotë e të singertë dhe me iniciativën e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare“, në ligjin “Për QKB“, në atë Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojnë shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, “EDEL MODEN” SHPK.

KREU I

Emërtimi, Forma Juridike, Selia, Kohëzgjatja, Objekti

Neni 1

Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “EDEL MODEN” SHPK.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqëria “EDEL Moden” SHPK, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”), e themeluar nga personat fizikë të sipërpërmendur, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë vetëm deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara.

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Secili ortak gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital. Kapitali i regjistruar i shoqërisë ndahet ndërmjet ortakëve në kuota, sipas këtij raporti.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë te **Rruga e Kavajës, zona kadastrale 8240, ish-Kombinati i Drurit „Misto Mame“, pranë UKT, Tiranë.**

Shoqëria mund ta ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4

Objekti

Objekti i kompanisë është: prodhim i pjesshëm dhe tërësor i artikujve të veshmbathjes/FASON, qepje, qëndisje dhe punime artizanale, riparime rrobaqepësie, stilim/dizenjim, prodhim dhe restaurim veshjesh e kostumesh (me materialet e veta dhe/apo të të tretëve), import – eksport, tregti me pakicë dhe shumicë e metrazheve, prodhimeve të papërfunduara, konfeksioneve dhe aksesorëve të tyre brenda dhe jashtë vendit; paraqitje produktesh nëpër ekspozita dhe sfilata, veprimtari kualifikuese; botim dhe shtypshkrim fletëpalosjesh, broshurash, librash dhe revistash mode në letër dhe në teknologji të tjera të mbartjes së

tekstit, publikime dhe aktivitete promociionale multimediale (në formatet web, film, video, audio etj.); krijime grafike për media tradicionale, elektronike, multimediale dhe online, marketing online, krijim dhe mirëmbajtje faqesh ëeb dhe veprimtari të ngjashme me këto; planifikim, këshillim dhe ofrim shërbimesh artistike për prodhimet televizive dhe kinematografike, për mediat, institucionet artistike, turizmin dhe çdo ent tjetër organizator apo pjesëmarrës në aktivitete social-kulturore dhe artistike; organizim eventesh; ndërmjetësim, dhënie me qera asetesh dhe shërbimesh, manaxhim talenti dhe imazhi; konkurse dhe spektakle brenda dhe jashtë vendit; teleshoping, tregti produktesh kozmetike, bizhuterish dhe artikujsh të tjerë industrialë, elektronikë, elektro-shtëpiakë dhe hidrosanitarë; transport mallrash për vete dhe të tretët. Shoqëria mund të kryejë dhe çdo veprimtari tjetër prodhuese e tregtare që nuk ndalohet me ligj si edhe ndërtimin e objekteve, rikonstruksionin, mirëmbajtjen, blerjen, shitjen, këmbimin, sistemimin dhe administrimin e pasurive të paluajtshme dhe konsulencën teknike, të lidhur me to.

Për zbatimin e objektit, shoqëria mund të plotësojë të gjitha veprimet tregtare, industriale, financiare, letra me vlerë dhe pasuri të paluajtshme, që do të jenë të nevojshme dhe/ose të dobishme, mund të paguajë garancitë, të marrë interesa dhe të ketë pjesëmarrje aksionare edhe në shoqëri të tjera apo me objekt të ngjashëm ose të lidhur me të.

Neni 5 Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

KREU II KAPITALI

Neni 6 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 000 lekë (një qind mijë lekë) dhe është i përbërë nga 2 kuota.

Kapitali i mësipërm është nënshkruar dhe shlyer tërësisht në të holla nga ortakët e shoqërisë përkatësisht :

Edmond Topi, zotërues i 1 kuote, me vlerë të përgjithshme 60.000 lekë, që përbëjnë 60 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Mirela Oktrova, zotërues i 1 kuote, me vlerë të përgjithshme 40.000 leke, që përbëjnë 40 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta). Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të të tretëve jashtë shoqërisë, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumicës së cilësuar që kërkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Marrja e vendimeve

Asambleja e Përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, vendos me votat e të paktën tri të katërtave të zotëruesve të kapitalit të shoqërisë, që janë pjesëmarrës në mbledhje.

Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 10 Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga një administrator.

Administrator i shoqërisë është **Znj. Mirela Oktrova**, e cila do të ushtrojë funksionet në këtë detyrë për një periudhë 5-vjeçare me të drejtë ripërtëritjeje.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë QKB-së.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në QKB.

Neni 11 **Kompetencat**

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga Asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, t'i paraqesë këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarrëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasë asamblenë e përgjithshme edhe në rastet e mëposhtme :

- Asambleja e Përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuarshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe

- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithë personave fizikë e juridikë, publikë dhe/ose privatë, vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12 **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13 **Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;

b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;

c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Asambleja e Ortakëve merr vendim me shkrim, në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.

Neni 14 **Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 15 **Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 16 **Dispozita perfundimtare**

Ky akt themelimi u redaktua në 4 ekzemplarë me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë juridike në gjuhën shqipe, të cilat pasi u miratuan në parim dhe nen për nen nga Ortakët themelues të shoqërisë tregtare “EDEL MODEN” SHPK, u nënshkrua rregullisht nga ortakët e mësipërm themelues, duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tyre origjinale.

Ngarkohet dhe autorizohet **Mirela Oktrova**, mbajtëse e kartës ID, me numër personal G55503201C për depozitim të këtyre akteve pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKB).

ORTAKËT

Edmond Topi

Dr.Mirela Oktrova